
PRINCIPLES OF EQUALITY AND NON-DISCRIMINATION

Ali MusliuFaculty of Law, SUT University – Tetovo, Republic of Macedonia ali.musliu@unite.edu.mk

Abstract: The requirement for equality before the law is at the core of most fundamental human rights. The first condition of justice is equality. Principles of equality and non-discrimination are the basic rights in most of written constitutions. The struggle for justice begins with the individual's efforts to recognize his/her fundamental rights (right to life), while equality is the starting point for all rights and freedoms. Advocacy and legalization of the principle and the idea of equality between people is the product of the French and American Revolutions. The most important acts adopted in the United States' Declaration of Independence in 1776, and the French Declaration of Human and Citizens' Rights in 1789 have set the basic standards of human rights and became a guide for modern states. Principles of equality and non-discrimination are the basis for operation of all other human rights, and in international legal documents. This also can be found in national legislation. These principles have in common positive and negative formulation of protecting individual. In theory, the concept of equality represents absence of discrimination, while respecting the principle of non-discrimination between people brings about equality. The work emphasizes the importance of equality which should never be underestimated. The principles of equality and non-discrimination are analyzed in interdependence within the human rights concept, and democratic values in modern societies. Research argues that a guarantee of equal treatment is essential to democracy and founded on the principle that every individual has equal value. Special analysis focuses on different states with different patterns of discrimination definitions. The paper tries to look for unified principles to determine how a country chooses a concrete model for defining the grounds for discrimination. But the analysis shows that most often their definition in national legislation is a political decision that reflects public opinion within a certain time. The focuses of the work are the states and societies that still suffer today from the consequences and burdens of the past. As a result of earlier discrimination, such as legal, economic, cultural and social etc, the conditions under which these categories now become "equal" in that formal aspect. They remain discriminatory in real life. Therefore states are authorized to take positive measures in favor of the relevant categories that have historically been discriminated against, which are literally and universally recognized as precautionary measures or preferential treatment or affirmative measures.

Keywords: Human Rights, equality, nondiscrimination, principles

PARIMI I BARAZISË DHE MOSDISKRIMINIMIT**Ali Musliu**Fakulteti Juridik, UT – Tetovë, Republika e Maqedonisë, ali.musliu@unite.edu.mk

Abstrakt: Kërkesa për barazi para ligjit është në kuptim thelbësor e drejta më themelore e njeriut. Kushti i parë i drejtësisë është barazia. Ajo zë vendin e parë në shumicën e kushtetutave të shkruara. Lufta për të drejtën fillon me përpjekjet e njeriut për tu njohur të drejtat e tij themelore (e drejta e jetës), ndërsa barazia është pika fillestare për të gjitha të drejta dhe liritë e tjera. Avokimi dhe legalizimi i parimit dhe idesë për barazi ndërmjet njerëzve është produkt i Revolucionit francez borgjez dhe atij amerikan. Aktet më të rëndësishme të aprovuara (Deklarata e pavarësisë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës e vitit 1776, Deklarata për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit e vitit 1789 dhe Deklarata për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit e vitit 1793), kanë vënë standardet themelore të të drejtave të njeriut dhe janë bërë udhërrëfyes të popujve dhe shteteve, me të cilat janë adoptuar dhe penetruar në aktet më të larta shtetërore dhe kanë fituar vend të rëndësishëm në historinë e njerëzimit. Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit paraqesin një bazë kryesore në operacionalizimin e gjitha të drejtave të tjera njerëzore si në dokumentet ndërkombëtare, po ashtu edhe në legjislacionin kombëtar. Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit paraqesin një formulim të përbashkët pozitiv dhe negativ të një principi të njëjtë. Në teori përqafohet koncepti se barazia paraqet mungesë nga diskriminimi, ndërsa respektimi i parimit të mosdiskriminimit në mes njerëzve sjellë deri te barazia. Punimi potencon rëndësinë e barazisë e cila nuk duhet të nënvlerësohet asnjëherë. Parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit, punimi i analizon si një fill që tërheq së bashku të drejtat e njeriut dhe vlerat e një shoqërie demokratike, të cilat rrjedhin prej tyre. Me besim, mund të thuhet se një garanci e trajtimit të barabartë është thelbësore për demokracinë dhe se demokracia është themeluar mbi parimin se çdo individ ka vlerë të barabartë. Analizë të veçantë fokusohet në shtetet e ndryshme që kanë modele të ndryshme të përcaktimit të bazave për diskriminim. Punimi mundohet të kërkon parime të unifikuara, sipas të cilave do të përcaktoheshe se si një shtet

zgjedh një model konkret për përcaktim të bazave për diskriminim, por analizat tregojnë se më së shpeshti përcaktimi i tyre në legjislacionet nacionale është një vendim politik, i cili reflekton opinionin publik brenda një kohe të caktuar. Fokus i punimit janë shtetet dhe shoqëritë që ende sot e kësaj dite vuajnë pasojat dhe barrën e së kaluarës. Si rezultat i diskriminimit të më hershëm (baza juridik, ekonomik, kulturorë, social etj), kushtet me të cilat këto kategori tani bëhen të “barabartë” në atë aspektin formal, përsëri ngelën diskriminimi dhe statusi i tyre diskriminues në jetën reale. Prandaj shtetet janë të autorizuar që në favor të kategorive përkatëse që historikisht janë diskriminuar të marrin masa pozitive, që në literaturë dhe botërisht njihen si masa ose trajtim preferencial ose masa afirmative.

Fjalët kyçe: Të drejtat e Njeriut, barazia, mos-diskriminimi, parimet

PARIMI I BARAZISË DHE MOS-DISKRIMINIMIT

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit paraqesin një bazë kryesore në operacionalizimin e gjitha të drejtave të tjera njerëzore si në dokumentet ndërkombëtare, po ashtu edhe në legjislacionin kombëtar. Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit paraqesin një formulim të përbashkët pozitiv dhe negativ të një principi të njëjtë. Termi “diskriminim” përdoret për të shënuar trajtimin e padrejtë ose mohimin e privilegjeve normale personave për shkak të racës, seksit, kombësisë ose fesë.¹⁶⁷ Në teori përqafohet koncepti se barazia paraqet mungesë nga diskriminimi, ndërsa respektimi i parimit të mosdiskriminimit në mes njerëzve sjellë deri te barazia. Rëndësia e barazisë nuk duhet të nënvlerësohet asnjëherë. Parimet e barazisë duhet të shihen si një fill që tërheq së bashku të drejtat e njeriut dhe vlerat e një shoqërie demokratike, të cilat rrjedhin prej tyre. Me besim, mund të thuhet se një garanci e trajtimit të barabartë është thelbësore për demokracinë dhe se demokracia është themeluar mbi parimin se çdo individ ka vlerë të barabartë.

Në teori ekzistojnë ndarje të këtij parimi në atë formal dhe material, relativ dhe absolut, direkt dhe indirekt, etj. Duke mos u thelluar në teoretizimin e më tutjeshëm të çështjes, do të elaborojmë ndarjen e principit të barazisë në atë formal dhe material. Barazia formale, ose siç ndryshe emërohet edhe si barazi juridike, nënkupton posedimin e të drejtave të njëjta dhe tretmanit të njëjtë, ndërsa barazia materiale nënkupton se rezultati i tretmanit duhet të jetë i njëjtë. Dallimi në mes të dy formave të barazisë qëndron në atë se barazia formale i referohet natyrës së tretmanit, ndërsa barazia materiale merret me rezultatin e një tretmani konkret.¹⁶⁸ Përgjithësisht, është e kuptueshme se barazia thjesht formale, që lidhet me detyrimin për të mos pasur dallim në trajtimin midis personave në situata të njëjta apo të ngjashme (diskriminim i drejtpërdrejtë), nuk është e mjaftueshme për të garantuar barazinë e vërtetë. Barazia në trajtim, pa lidhje me dallimet në mes të personave ose grupeve të personave në fjalë, mund të veprojë në mënyrë të tillë që të shkelë pengesat ekzistuese. Kështu, ndalimi i detyrueshëm ndaj të gjithë punonjësve për të mbuluar kokën formalisht, është trajtim i barabartë (për aq kohë sa nuk bëhen përjashtime), por kjo mund të shihet lehtësisht si e pafavorshme dhe diskriminuese për ato grupe, për të cilët mbulimi i kokës me perçe mund të ketë rëndësi kulturore ose fetare. Mbrojtja nga diskriminimi 'i tërthortë' ofron një mundësi të mirë për të sfiduar diskriminimin që rrjedh nga faktorë strukturorë. Diskriminimi i tërthortë shpjegohet më së miri nga një politikë, rregull apo praktikë që në thelb dhe në dukje është neutrale, sepse teorikisht vlen për të gjithë, e megjithatë, mund të jetë diskriminues në mënyrë të tërthortë nëse ka një ndikim të ndryshëm tek njerëzit që i përkasin një grupi të veçantë.¹⁶⁹ Ky koncept i diskriminimit 'të tërthortë' tashmë njihet mirë, edhe në sferën e diskriminimit racor dhe etnik dhe është pasqyruar në masat legjislative të BE, ndër të tjera, të diskriminimit racor, të përkatësisë etnike dhe fetare.¹⁷⁰

Përveç kësaj, modeli i diskriminimit të tërthortë vetëm ndalon kushtet diskriminuese 'të pajustificuara'. Për shembull, kur disa individë pretendonin se ishin diskriminuar për shkak se kishin dalë në pension dhe vendimi i qeverisë për të hequr disa përfitime i kishte prekur ata në mënyrë disproporcionale, Komiteti i të Drejtave të Njeriut theksoi se nëse kjo gjë nuk kishte ndikuar në mënyrë disproporcionale tek kategoria e personave të një race ose

¹⁶⁷ Më tepër shih në: Doebbler, C. (2007). *Introduction to International Human Rights Law*. CD Publishing, Washington, DC, USA. Fq. 103-106.

¹⁶⁸ Më tepër në lidhje me konceptin e barazisë dhe mosdiskriminimit shih në: Smith, Rh. (2010). *Textbook on International Human Rights Law*. Oxford University Press, 4th Edition, fq 189-210.

¹⁶⁹ Kjo ndoshta shpjegohet më mirë, duke vërejtur rastin e Gjykatës së Lartë të SHBA që formuloi parimin, në çështjen *Griggs v Pushtetit të Dukës*.

¹⁷⁰ Direktiva e Këshillit 2000/43 /KE "Zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave, pavarësisht nga origjina racore ose etnike" dhe Direktiva e Këshillit 2000/78/EC "Krijimi i një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion".

ngjyre të veçantë dhe heqja e këtyre të drejtave ka pasur baza të arsyeshme dhe objektive, ndaj nuk ka asnjë shkelje.¹⁷¹

Në rast të pranimit të pabarazisë në mes njerëzve i gjithë koncepti i të drejtave të njeriut rrënohet që në esencë. Të drejtat e njeriut janë të drejta të lindura me vetë faktin që njeriu i gëzon si qenie njerëzore. Ndryshimi eventual i kësaj të drejte universale, me atë që njerëzit do të jenë të barabartë në kuadër të kategorisë ose llojit të vetë, si psh. i bardhi me të bardhin, Gjermani me Gjermanin, Maqedoni me Maqedonin, Shqiptari me Shqipëtarin, mashkulli me mashkullin, etj, respektivisht merren për bazë cilësitë përkatëse të njeriut që nuk janë karakteristike për të gjithë njerëzit. Prandaj në këtë mes nuk ka asnjë lloj argumenti që një grup është më njerëzore se tjetra, ose më me vlerë se sa grupacioni tjetër shoqëror. Simptomatike është se avokuesit e pabarazisë njerëzore nisen nga supozimi se ato janë pjesë e grupit që janë më të “lartë” dhe të “vlefshëm” nga të tjerët.

NOCIONI I DISKRIMINIMIT

Avokimi dhe legalizimi i parimit dhe idesë për barazi ndërmjet njerëzve është produkt i Revolucionit Francez Borgjez. Aktet më të rëndësishme të aprovuara (Deklarata e pavarësisë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës e vitit 1776, Deklarata për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit e vitit 1789 dhe Deklarata për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit e vitit 1793), kanë vënë standardet themelore të të drejtave të njeriut dhe janë bërë udhërrëfyes të popujve dhe shteteve, me të cilat janë adoptuar dhe penetruar në aktet më të larta shtetërore dhe kanë fituar vend të rëndësishëm në historinë e njerëzimit.¹⁷² Paralelisht me përpjekjen nacionale për të njohur dhe legalizuar të drejtën në barazi dhe mosdiskriminin, bashkësia ndërkombëtare nga gjysma e dytë e shekullit të XX, gjithnjë e më shumë angazhohet për të siguruar barazinë e plotë ndërmjet njerëzve, pa marrë parasysh dallimet racore, kombëtare, fetare, gjuhësore, etj. Konfirmimi i kësaj është se ka një numër të konsiderueshëm të instrumenteve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut të ratifikuara nga shtetet anëtare të OKB-së, të cilat ndalojnë diskrimininin në baza të shumta. Ky parim, me formulime të ndryshme, është i ngulitur në Kartën e Kombeve të Bashkuara (1945), Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut (1948), Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (1966), Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966), Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës (1989), Konventën Ndërkombëtare mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve-Emigrantëve (1990), Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (1950/53).

Të gjitha traktatet e të drejtave të njeriut siç shihet më larët përfshijnë një klauzolë për barazinë,¹⁷³ ashtu siç bëjnë shumica e strukturave të brendshme kushtetuese. Në mënyrë të ngjashme në nivel kombëtar, shpesh ka ligje gjithëpërfshirëse që ndalojnë diskrimininin. Megjithatë, ka mënyra të ndryshme për të siguruar barazinë dhe mosdiskrimininin. Disa nga këto janë më efektive se të tjerët. Për shembull, të gjitha traktatet e drejtave të njeriut trajtojnë barazinë formale apo qëndrueshmërinë në trajtimin e rasteve, me anë të ndalimit të trajtimit të ndryshëm të pajustificuar. Kjo njihet si 'diskrimininim i drejtpërdrejtë'. Të tjera vendosin një detyrim ndaj shteteve për të siguruar barazinë substanciale, sidomos ndalimin e kushteve të pajustificuara, të cilat, edhe pse duken neutrale, pengojnë disa grupe të mbrojtura, duke bërë kështu 'përparime drejt diversitetit'.¹⁷⁴ Kjo njihet si 'diskrimininim jo i drejtpërdrejtë'. Garancia për mosdiskrimininim në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Neni 14), për shembull, tani ndalon masat neutrale, të cilat ndikojnë negativisht ndaj disa grupeve të caktuara minoritare.¹⁷⁵ Termi diskrimininim është shpjeguar në nenin 1 të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskrimininimit Racial, ku me tutje shpjegohet se diskrimininim racor ka të bëjë në çdo dallim, përjashtim, kufizim ose dhënie të përparësive, që është e bazuar në racë, ngjyrë, prejardhje, origjinë kombëtare ose etnike, që ka për qëllim ose për rezultat të shkatërrorë ose të komprometoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në kushtet e barazisë, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, në fushat politike, ekonomike, sociale dhe kulturore ose në çfarë do fushe tjetër të jetës politike.¹⁷⁶ Siç përmendëm kjo e drejtë është e paraparë edhe me aktet më të larta të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Kështu në Kartën e Kombeve të Bashkuara, në veçanti në nenin 1 (3) dhe neni 55 (1), bëjnë fjalë për mbrojtjen e të

¹⁷¹ *Althammer v Austrisë* (Komiteti i të Drejtave të Njeriut); *Marckx v Belgjikës*

¹⁷² Shih më gjerësisht në Kapitullin II.

¹⁷³ Neni 1, 2 dhe 7 të DUDNJ; nenet.1 KNDCP, 2, 3 dhe 26; Neni.1, 2 dhe 3 i KNDESK; Arts.1 CERD dhe 2; Arts.1-4 CEDAW; Përkatësisht Nenet 2 CRC, 50 dhe 30; CRPD Nenet 2, 3, 4, 5 dhe 12

¹⁷⁴ S. Fredman (ed), *Diskrimininimi dhe të Drejtat e Njeriut, Çështja e Racizmit* (Oxford: OUP, 2001), fq.24

¹⁷⁵ Shiko *Thlimmenos v Greqisë* [2000] 9 BHRC 12

¹⁷⁶ Neni 1 i Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskrimininimit Racial. Teksi integral i kësaj Konvente në anglisht: Brownlie, I. (2009). *Basic Documents in International Law*. Oxford University Press, fq. 231-243.

drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ku theksohet se kjo duhet bërë pa kurrfarë dallimi për sa i përket racës, gjinisë, gjuhës apo fesë, që në thelb paraqet ndalim të diskriminimit.¹⁷⁷ Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, e ka bërë të qartë se 'zbatimi i dallimeve, përjashtimeve, ndalimeve dhe kufizimeve bazuar ekskluzivisht për arsye të racës, ngjyrës, prejardhjes apo origjinës kombëtare apo etnike ... është një shkelje flagrante e qëllimeve dhe parimeve të Kartës së [OKB]'.¹⁷⁸ Lidhur me racizmin, Gjykata përcakton se 'një nga detyrimet themelore të së drejtës ndërkombëtare të të gjitha shteteve është mbrojtja nga diskriminimi racor'.¹⁷⁹

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1948), më tutje i përpunon normat e Kartës së OKB-së për barazi dhe mosdiskriminim, dhe i parasheh në tërësinë e normave të kësaj Deklarate. Deklarata parasheh se të drejtat nga ajo i takojnë çdo njeriu pa kurrfarë dallimi për sa i përket racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, mendimit politik ose mendimit tjetër, origjinës kombëtare ose shoqërore, pasurisë, lindjes ose rrethanave të tjera.¹⁸⁰ Ndalimi i diskriminimit është paraparë edhe me marrëveshje të shumta ndërkombëtare dhe regjionale. Sidomos rol të rëndësishëm dhanë edhe organizatat e specializuara të OKB-së, që kanë miratuar rregulla të shumta më precize të cilat ndalohet dhe gjykohej praktika e dallimeve ndërmjet njerëzve, jotoleranca, urrejtja dhe mohimi i lirisë dhe barazisë. Në këtë mes vlen të potencohet Konventa Ndërkombëtare për Eliminim e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial (1965/69), Konventa për Diskriminim në Fushën e Punësimit dhe Profesionit (1958), Konventa Kundër Diskriminimit në Fushën e Arsimit (1960), etj.¹⁸¹

Në kuadër të akteve regjionale Evropiane vlen të përmendim edhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, e cila në nenin 14 ndalon diskriminimin dhe i detyron shtetet të sigurojnë gëzimin e të drejtave dhe lirive nga kjo konventë pa asnjë diskriminim të bazuar në gjini, racë, ngjyrë lëkure ose shoqëror, përkatësi të ndonjë pakice kombëtare, pasuri, lindje ose status tjetër.¹⁸² Diskriminimi është i ndaluar edhe me akte të miratuara nga OSBE. Akti Final i Konferencës Evropiane e vitit 1975 parasheh se “shtetet pjesëmarrëse do t'i respektojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, duke përfshirë edhe lirinë e mendimit, ndërgjegjes, bindjes fetare, për të gjithë pa dallim race, seksi, gjuhe e feje. Shtetet në të cilat ekzistojnë pakicat kombëtare duhet të “respektojnë të drejtën e personave që u përkasin këtyre pakicave për barazi para ligjit, do t'u japin atyre mundësi të plotë për të gëzuar me të vërtetë të drejtat dhe liritë themelore dhe, në këtë mënyrë, të mbrojnë interesat e tyre të ligjshme në këtë fushë”.¹⁸³

BAZA E DISKRIMINIMIT

Ekzistojnë definicione të ndryshme mbi “bazën për diskriminim”. Një nga definicionet më shpesh të cituara është ai i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDN), sipas të cilës, kjo është një “veçori personale (status) në bazë të së cilës, personat ose grupet e personave dallohen mes vete”.¹⁸⁴ Sipas definicionit tjetër, baza për diskriminim është karakteristike për një individ të cilin nuk duhet konsideruar si relevant në kuptimin e trajtimit të ndryshëm ose gjatë gëzimit të disa përfitimeve të caktuara. Definicioni më i pranuar mbi bazën për diskriminim, e gjejmë në Manuelin e të Drejtës Evropiane të Mos-diskriminimit si vijon: Baza për diskriminim është një veçori e mbrojtur mbi të cilën nuk duhet të bazohet trajtimi i ndryshëm i palejuar, dhe e cila mund të jetë një tipar personal ose status, ose një veçori e ngjashme personale ose status, përmes të së cilës një person, ose grup personash identifikohet me ndonjë racë të caktuar, ngjyrë të lëkurës, përkatësi etnike, gjuhë, shtetësi, gjini dhe fis, orientim seksual, fe, bindje, arsimim, aftësi të kufizuara mendore ose trupore, moshë, gjendje familjare ose martesore, gjendje shëndetësore, etj.

¹⁷⁷ Teksti në anglisht: Charter of the United Nations, *Ibidem*, fq. 2-27.

¹⁷⁸ Opinioni këshillimor mbi pasojat ligjore për shtetet lidhur me praninë e vazhdueshme të Afrikës së Jugut në Namibi [1970] GJND-16 në 57.

¹⁷⁹ Rasti *Barcelona Traction (Faza II)*, ICJ 3, 514-517

¹⁸⁰ Neni 2 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut. Teksti në anglisht: *Ibidem*, fq. 192-195.

¹⁸¹ Dokumentet në dispozicion: Brownlie, I. (2009). *Basic Documents in International Law*. Oxford University Press.

¹⁸² Hariss, O'Boyle & Warbrick. (2009). *Law of the European Convention on Human Rights*. Oxford University Press. Second Edition, fq. 577-613.

¹⁸³ Më shumë lidhur me diskriminimin shih në: Gruda, Z. (2001). Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut. UP, fq. 163-184.

¹⁸⁴ *Kjeldsen, Busk Madsen & Pedersen vs. Danimarkës* (App, 5095/71, 5920/71, 5929/72), 7 dhjetor, v. 1976, Seria A Nr. 23 (1979-90), 1 EHRR 711 §56.

¹⁸⁵Ato legjislacione të cilat bazat për diskriminim i vërtetojnë në formë të listave të bazave, më së shpeshti nuk i qasen përcaktimit të asaj se ç'është baza për diskriminim, por këtë e zgjidhin ose nëpërmjet të numërimit të tipareve personale ose të statusit, mbi të cilat nuk lejohet të mbështetet trajtimi i ndryshëm i palejuar, ose lejojnë që këto të caktohen përmes praktikës. Por, jo çdo veçori personale ose status mund të paraqesë dhe bazë për diskriminim. Caktimi nëse veçoria ose statusi mbi të cilin mbështetet dallimi mund të konsiderohet si një bazë e mbrojtur për diskriminim, është qartësuar më poshtë. Ekzistojnë terme të ndryshme që përdoren për “bazën për diskriminim”. Veç këtij termi, përdoren dhe: baza e mbrojtur, tipari i mbrojtur, simboli i dallimit, baza për mbrojtje, baza diskriminatore, etj.

Shtetet e ndryshme kanë modele të ndryshme të përcaktimit të bazave për diskriminim. Mund të kërkohen parime të unifikuara sipas të cilave do të përcaktoheshe se si një shtet zgjedh një model konkret për përcaktim të bazave për diskriminim, por analizat tregojnë se më së shpeshti përcaktimi i tyre në legjislacione nacionale është një vendim politik, i cili reflekton opinionin publik brenda një kohe të caktuar. Varësisht nga ajo se si janë caktuar bazat në kornizën ligjore në një shtet, studiuesja e njohur Sara Fredman¹⁸⁶ përcakton tre modele të caktimit të bazave për diskriminim:

- Modeli me ndalesë të përgjithshme: veçoria kryesore e këtij modeli është ekzistimi i një dispozite të përgjithshme për mbrojtjen e barazisë së të gjithëve para ligjeve. Në këto vende, caktimi i bazave që do të mbrohen u lihet në përgjegjësi të plotë gjykatave. Modeli i këtillë ekziston në SHBA dhe në Kanada.
- Modeli i mbyllur: diskriminimi ndalohet vetëm në baza përpikërisht të caktuara. Zgjerimi i mbrojtjes nga diskriminimi mbi baza tjera mund të bëhet vetëm me ndryshime ligjore, dhe jo nëpërmjet të praktikës së gjykatave dhe organeve. Modeli i këtillë ekziston në BE (duke u bazuar mbi direktivat), si dhe në Britaninë e Madhe dhe në Suedi.
- Modeli i hapur: diskriminimi ndalohet në mënyrë që numërohen disa baza, dhe lista lihet e hapur, duke shtuar në vijim “dhe ndonjë bazë ose status tjetër”, “baza siç janë”, etj. Këtu gjykatat dhe organet kanë një liri të caktuar gjatë përcaktimit se cilat veçori personale ose statuse do të mund t'i konsiderojnë si të mbrojtura në këtë pjesë të hapur. Kështu modeli ekziston në GjEDN, në Kartën e BE-së, dhe në Maqedoni.¹⁸⁷

Këto tre modele janë bazë dhe pikënisje për përcaktimin e shkallës së lirisë së interpretimit, të cilën, varësisht nga modeli, e kanë gjykatat, tribunalet, ose organet tjera relevante shtetërore, të mund të caktohet rëndësia të cilën kanë definicionet e bazave në një sistem të caktuar të mbrojtjes nga diskriminimi, varësisht nga modeli i përdorur.

NË VEND TË PËRFUNDIMIT – MASAT PËR PËRMISIMIN E PASOJAVE TË DISKRIMINIMIT TË MËHERSHËM

Disa shtete dhe shoqëri ende sot e kësaj dite vuajnë pasojat dhe barrën e së kaluarës. Si rezultat i diskriminimit të më hershëm (baza juridik, ekonomik, kulturorë, social etj), kushtet me të cilat këto kategori tani bëhen të “barabartë” në atë aspektin formal, përsëri ngelën diskriminimi dhe statusi i tyre diskriminues në jetën reale. Prandaj shtetet janë të autorizuar që në favor të kategorive përkatëse që historikisht janë diskriminuar të marrin masa pozitive, që në literaturë dhe botërisht njihen si masa ose trajtim preferencial ose masa afirmative. Këto masa në veçanti janë të parapara me nenin 1, paragrafi 4 i Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial ku potencohet: “Masat e veçanta që merren me të vetmin qëllim që të sigurojnë përparimin adekuat të një numri të konsiderueshëm të grupeve racore, etnike ose të individëve që kanë nevojë për mbrojtjen e nevojshme për të garantuar gëzimin dhe ushtrimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, në kushte barazie, nuk konsiderohen si masa diskriminimi racial, me kusht që këto masa të mos kenë për pasojë ruajtjen e të drejtave të veçanta për grupe racore të ndryshme dhe të mos mbeten në fuqi pasi të jenë arritur objektivat për të cilat janë

¹⁸⁵ Handbook on European Non-discrimination Law'. EU FRA and CoE, 2010.97

¹⁸⁶ Fredman, S. (2011). *Discrimination Law*. 2nd edn, OUP, fq. 110-130.

¹⁸⁷ Duke analizuar një numër të madh të sistemeve ndërkombëtare dhe të brendshme për përcaktim, interpretim dhe aplikim të bazave për diskriminim, studiuesja Fredman kategorizoi tri modele bazë të diskriminimit.

marrë”¹⁸⁸. Masat të diskriminimit pozitiv ose afirmativë parasheh edhe Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave. Këto masa janë të parapara në nenin 4 të Konventës, ku potencohet se: “Miratimi i masave të përkohshme të veçanta nga shtetet palë që synojnë përsheptimin de facto të barazisë midis burrit dhe gruas, nuk konsiderohet diskriminim, siç është përkufizuar në këtë Konventë, por në asnjë mënyrë nuk duhet të ketë për pasojë ruajtjen e normave të pabarabarta apo të veçanta. Qëllimi i gjithë këtyre masave kanë për objektiv të përmisojnë padrejtësinë historike të komuniteteve përkatëse, ku gradualisht do të arrin në një pozitë të barazisë reale. Këto masa shpesh janë të parapara si favorizime të përkohshme të kategorive të caktuara, ose grupacioneve të caktuara njerëzish, për të cilët objektivist dihet, se në mënyrë sistemore kanë qenë viktimë e diskriminimit. Masat e diskriminimit pozitiv duhet të jenë të përkohshme, respektivisht të zgjasin aq sa është nevoja që anëtarët e grupit të marginalizuar të barazohen me pjesën tjetër të komunitetit. Nëse këto masa në jetën reale vazhdojnë pa një kufizim dhe afatizim kohorë, rezultati mund të jetë në krijimin e pabarazisë në favor të grupacionit që kushtimit deri dje kanë qenë të diskriminuar.

LITERATURA

- [1] Brownlie, I. (2009). *Basic Documents in International Law*. Oxford University Press, fq. 231-243;
- [2] Doebbler, C. (2007). *Introduction to International Human Rights Law*. CD Publishing, Washington, DC, USA. Fq. 103-106;
- [3] Direktiva e Këshillit 2000/43 /KE "Zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave, pavarësisht nga origjina racore ose etnike" dhe Direktiva e Këshillit 2000/78/EC "Krijimi i një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion";
- [4] S. Fredman (ed), *Diskriminimi dhe të Drejtat e Njeriut, Çështja e Racizmit* (Oxford: OUP, 2001), fq. 24;
- [5] Konventën Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të diskriminimit (CERD) dhe Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW);
- [6] Kadriu, B. (2007). *Parimi i mosdiskriminimit në të drejtën ndërkombëtare*. Tetovë;
- [7] Hariss, O’Boyle & Warbrick. (2009). *Law of the European Convention on Human Rights*. Oxford University Press. Second Edition, fq. 577-613;
- [8] Gruda, Z. (2001). *Mbrojta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut*. UP, fq. 163-184;
- [9] Kjeldsen, Busk Madsen dhe Pedersen vs. Danimarkës (App, 5095/71, 5920/71, 5929/72), 7 dhjetor, v. 1976, Seria A Nr. 23 (1979-90), 1 EHRR 711 §56;
- [10] *Handbook on European Non-discrimination Law*. EU FRA and CoE, 2010.9
- [11] Smith, Rh. (2010). *Textbook on International Human Rights Law*. Oxford University Press, 4th Edition, fq. 189-210;
- [12] Wagner dhe J.M.W.L. v Luxembourg, App.No.76240/01, 28.06.2007. Si në: O’Connell R, *Cinderella comes to the Ball: Art 14 and the right to non-discrimination in the ECHR*, 29 *Legal Studies* 2 (2009) 211, 223;

¹⁸⁸ Miratuar dhe hapur për nënshkrim e ratifikim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2106 A (XX) të datës 21 dhjetor 1965. HYRË NË FUQI: më 4 janar 1969. Brownlie, I. (2009). *Basic Documents in International Law*. Oxford University Press.